



## **ANEKSI NR.2: SPECIFIKIMET TEKNIKE**

### **1. Riparim i rregullatorit automatik të shpejtësisë (RASH) Agregati Nr. 1**

Rregullatori automatik i shpejtësisë është në punë me dorë prej shumë kohe, gjë që teknikisht është e palejueshme për një periudhë të gjatë. Në rastin konkret rregullatori tek ky agregat nuk funksionon normalisht, pasi devijatori i tij gjatë monovrimeve të rrymës së ujit nuk funksionon, ku për pasojë i gjithë uji që shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike bie në pus dhe ikën, gjë që shkakton boshatisjen e bazenit. Prandaj nisur nga ky fakt, rregullatori i shpejtësisë duhet të hapet.

Fillimisht, duhet të bëhet ndalimi i ujit tek saracineska e agregatit, ku bypassi i saj fillimisht duhet të lihet i hapur dhe pastaj të mbyllet për arsye sigurie në punë.

Duhet të bëhet hapja e kapakeve anësor të rregullatorit për të parë pjesët lidhëse të devijatorit dhe gjilpërës, si dhe regjistrat ku duhet të bëhen krahasimet me agregatin në punë, dhe të evidentohen levizjet/diferencat mes tyre, sado të vogla të jenë.

Pas hapjes së kapakeve, duhet të zërthehet volanti së bashku me vidën shtrenguese. Duhet të zmontohet komplet bazamenti i levës bllokese me automatic dore. Pas zmontimit duhet të kontrollohet për papastërti të mundshme, të cilat duhet të pastrohen.

Duhet të zmontohet dhe dadoja shtrënguese dhe të bëhet lëvizja me dorë e bllokut të pistonave për të parë si ato lëvizin në bllok, dhe duhet të shihet nëse ka ndonjë bllokim mes tyre që pengon funksionimin e duhur teknik dhe në rast se ka, duhet të zërthehen me tej elementet e tjerë të lidhjes.

Në fund të ditës, duhet të bëhet montimi i të gjithë elementëve për të mos penguar furnizimin e popullatës me ujë nga reductorët.

Ditën e radhës së punimeve duhet të bëhet zmontimi i pjesëve, të cilat u montuan një ditë më parë, duhet të zmontohet fllanxha lidhëse me udhëzuesin si dhe dy krahët e pjesës lidhëse të devijatorit.

Më pas duhet të bëhet zmontimi i dadove fiksuese duke hequr fiksuesen e saj të pistonit të devijatorit së bashku me bllokun e saj. Vazhdon me heqjen e bazamentit, ku janë montuar pistonat e vegjël të automatikës, ku në këtë rast janë jashtë funksionit pasi agregati është në punë me dorë.

Pas zmontimit, duhet te hiqet kunji fiksues i udhezuesit me aksin dhe duhet te behet shfiletimi i aksit nga udhezuesi. Pas kesaj, duhet te terhiqen nepermjet aksit dy pistonat dhe duhet te nxirren nga cilindri ne shesh.

Në këtë moment duhet të kontrollohet për bllokimin e dy pistonave. Ne rast se pistonat janë të bllokuar duhet të bëhet nxjerrja jashtë e tyre me vinc, dhe zmontimi duhet të bëhet në kushte të përshtatshme teknike, që garantojnë pastërtine dhe profesionalizimin e nevojshëm. Zberthimi i tyre duhet të bëhet me prese hidraulike ose pajisje të tjera speciale.

Pas zberthimit të tyre, duhet të kontrollohet për papastërti mes pistonave dhe për ndryshk. Gjithashtu duhet te kontrollohet aksi per te pare gjendjen e tij dhe filetat e shtrengimit te dados bllokuese të pistonit të gjilpërës dhe udhëzuesit, dhe ne rast se janë të dëmtuara/shtrembëruara, duhet te korrigohen/drejtohen dhe filetot të hapen përsëri.

Pas kësaj duhet të bëhet montimi i të gjitha pjesëve të zmontuara në rregullator, duke i lubrifikuar me vaj dhe graso në vendet përkatëse të tyre dhe duhet të lidhet shtanga e devijatorit.

Pas kësaj hapet saracineska përkatëse e agregatit së bashku me bypasin dhe duhet të lëshohet agregati në boshllëk pa sinkronizim për arsye të gjeneratorit për tharjen e tij.

Pas riparimeve të mësipërme, devijatori duhet të hyjë në rrymë në kohën e duhur. Agregati duhet të lëshohet me ngarkesë dhe të provohen nyjet lidhëse që janë zberthyer gjatë punës në rregullator. Volanti i hapjes pas riparimeve duhet të punojë lirshëm në hapje dhe mbyllje.

## **2. Riparim i devijatorit Agregati Nr. 1**

Riparimi i devijatorit konsiston në riparimin e gjilpërës së devijatorit. Fillimisht duhet siguruar materialet teknike te cilat do te vihen ne dispozicion nga Reparti Teknik i HEC Lanabregas. Do të bëhet ndalimi i ujit tek saracineska e agregatit ku bypasi i saj fillimisht lihet i hapur dhe me pas mbyllet për arsye sigurie në punë. Do te behet pastaj hapja e kapakeve anesor ne rregullator per te pare pjeset lidhese te saj te devijatorit dhe gjilperes si dhe regjistrat ku duhet te behen krahasime me agregatin ne pune me te njejen hapje dhe duhet te konstatohen levizjet e vogla te mundshme mes tyre. Me pas do te behet zberthimi i volantit se bashku me viden shtrenguese, zmontimi komplet i bazamentit te leves bllokuese atomatike-me dore, ku duhet te pastrohen dhe papastertite qe mund te gjenden aty. Pastaj duhet te zmontohet dadoja shtrenguese e vidhosur pergjate aksit ne pistonin e brendshem i cili i perket pistonit te gjilperes dhe do te behet levizja me dore e komplet bllokut te pistonave para mbrapa per te pare se si ato levizin ne bllok dhe te evidentohen bllokimet e mundshme ne kete levizje (qe sigurisht egzistojne pasi jane arsyeja qe devijatori nuk funksionin sic duhet). Ne rast bllokimi duhet te behet zberthimi me tej i elementeve te tjere lidhes per nxjerrjen jashte te ketij blloku pistonash, ku bejne pjese ai i gjilperes dhe devijatorit.

Me pas duhet te zmontohet fllanxha lidhese me udhezuesin, pjeset lidhese te devijatorit ng ate dyja krahet, zmontimi i i udhezuesit ku eshte filetuar aksi, zmontimi i dados fiksuese te saj te pistonit devijator se bashku me bllokun e saj. Pastaj duhet te behet heqja e bazamentit ku jane montuar pistonat e vegjel te automatikes ku ne kete rast jane jashte fnksionit pasi agregati eshte ne pune me dore dhe sherben per lubrifikimin e pistonave nga dritaret perkatese.

Pasi te behen te gjitha zmontimet duhet te hiqet kunji fiksues i udhezuesit me aksin dhe te behet shfiletimi i aksit nga udhezuesi. Pastaj nepermjet ketij aksi duhet te nxirren jashte te dy pistonat nga cilindri. Pas konstatimit perseri te bllokimit te pistonave, duhet te perdoren mjetet e duhura ne uzinat perkatese nepermjet presave hidraulike ose paisjeve te tjera speciale per te beret e mundur zberthimin e tyre nga njeri-tjetri. Gjate zmontimit duhet te behet kujdes qe te mos demtohen pistonat dhe diametri i tyre.

Ne rast se aksi eshte i deformuar duhet te behet drejtimi i tij ne uzinat perkatese te specializuara dhe gjithashtu te behet rregullimi i filetove perkatese.

Pas pastrimit te pistonave, duhet te behet lubrifikimi dhe pastrimi i tyre me leter zmerile duke hequr pjeset e vrara te tyre dhe duke bere zmuso derisa pistonat te levizin lirshem Brenda njeri-tjetrit.

Pas kesaj duhet te behet perseri montimi i te gjitha pjeseve te zmontuara, sipas radhes dhe te behet testimi i funksionimit te devijatorit.

Ne rast se keto punime nuk perfundojne deri ne fund te dites se punes, duhet te behet perseri montimi i ketyre elementeve per te mos penguar furnizimin e populates me uje nga reduktoret, per tu rihapur perseri ditën e nesërme te punes dhe per te vazhduar punen e mbetur.

### **3. Riparim i sistemit të frenimit të Agregatit Nr. 1**

Riparimi i valvules se frenimit konstaton ne hapat si me poshte:

1. Cmونتim i valvules se frenimit nga vendi.
2. Cmونتim i sistemit te aksesoreve frenues.
3. Zevendesim i aksesoreve te demtuar dhe jo-funksional.
4. Montimi i valvules se frenimit bashke me aksesoreve.
5. Prova ne kushtet e punes.

### **4. Riparim i kuzhinetave të Agregatit Nr. 2**

Tek kushineta Nr 3 e AG 2 eshte shume kryesore dhe shume specifike perberja e materialit mbushes i cili duhet Babit 83 si material kryesor dhe material ndihmes eshte kallai. Pasi te jene

berë përzierjet në raportet e caktuara teknike 1:3 të tyre duhet bërë mbushja e kushinetës dhe tornimi sipas parametrave të caktuar teknik i cili është  $\phi$  199 mm.

## **5. Riparim celesi 35kV me gaz SF6**

Riparimi i celesit 35kV me gaz SF6 konstaton në kontrollin e përgjithshëm të celesit dhe evidentimin e problemeve/nevojës për nderhyrje. Duhet të bëhet kontrolli për rrjedhje gazi. Duhet të bëhet hapja e celesit dhe të bëhen riparimet përkatëse në rozeta dhe shtanga në rast se janë me probleme. Sipas ecurisë së punës së celesit dhe sipas raportit teknik nga stafi që e manovron, celesi ka probleme në kyçje-çkyçje. Kjo lidhet me bobinat e komandimit të cilat duhen ndërruar. Pas të gjitha riparimeve, celesi duhet të testohet dhe të punojë normalisht.